

Tretësirat janë sisteme homogjene të përbëra nga dy ose më shumë komponentë. Nëse nga dy substanca është formuar një përzierje homogjene, një përzierje të tillë e quajmë tretësirë. Tretësirat përbëhen prej dy komponentëve; tretësit dhe substancës së tretur. ^[1] Tretësi është komponentë e cila gjendet në sasi më të madhe, ndërsa substanca e tretur është komponentë me sasi më të vogël në tretësirë.

Substanca e tretur (B) + Tretësi (A) = Tretësira (T)

Tretësira ka gjendje agregate të njejtë me gjendjen agregate të tretësit. Procesi i lidhjes së molekulave të tretësit joujor (amoniakut të lëngët, metanolit , etanolit, flourhidrikut etj,) në jone të substancës së tretur quhet **Solvatim**. Produktet e këtij procesi **Solvate**. Në rastet ku si tretës përdoret uji procesi quhet **Hidratim**. Produktet e këtij procesi quhen **Hidrate**. Uji në disa hidrate

mund të formojë kristalhidrate, si: x , etj, kjo sasi e ujit e cila është pjesë përbërëse e strukturës së kristalit, quhet Uji Kristalor.

Sipas gjendjes agregate tretësit mund të ndahen në nëntë grupe kryesore. Më të rëndësishme janë:

- tretësit e lëngët (ujë-alkool, ujë-sheqer)
- e ngurtë, [Aliazhet](#) (Ar- Bakër)

Tretësi më i mirë dhe më universal i substancave kimike është uji. Uji si molekulë polare ka aftësi të mëdha për të tretur substanca të ndryshme, mirëpo uji nuk ka aftësi për tretjen e shumë substancave organike, sepse ato janë jopolare. Për tretjen e këtyre substancave jopolare përdoren tretës jopolarë, si : eteri, kloroformi, benzeni et

Ndarja e tretësirave

Duke u bazuar në madhësinë e grimcave që formojnë tretësit, tretësit ndahen në:

- Tretësira të vërteta, të cilat përbëhen prej grimcave që kanë diametër afro 1nm
- Tretësira koloidale, të cilat janë të përbëra prej grimcave me madhësi prej 1 deri 100 nm

Lëngjet dhe substancat e ngurta të tretura në gaze quhen *Aerosole*, si psh: Deodorantët, Mjegulla, Tymi

Emulzionet janë koloide në të cilat lëngjet janë të tretura në lëngje tjera apo substanca të ngurta, si: Majonezi, Djathi

Solet janë koloide kur substanca e ngurtë tretet në lëngje apo substanca tjera të ngurta, si: Gelli, Ngjyrat

- Suspensionet janë përzierje heterogjene me grimca të pezulluara, të cilat pas një kohe fundërojnë, këto tretësira përbëhen prej grimcave me diametër mbi 100nm.

Varësisht nga sasia e substancës së tretur dhe tretësit, ekzistojnë tri lloje të tretësirave:

- Të pangopura, atëherë kur tretësi mund të tretë sasi të reja të substancës së tretur
- Të ngopura, kur në një temperaturë të caktuar, tretësi nuk mund të tret më substancë
- Të tejngopura, kur përmban më tepër substancë të tretur sesa tretësira e ngopur. Kjo tretësit është jo stabile, sepse nën ndikimin e kushteve të jashtme (tundja) menjëherë shndërrohet në tretësit të ngopur, sepse tepërcia e substancës së tretur ndahet në formë të kristaleve.

Tretësirat janë përzierje homogjene e dy ose më shumë komponentëve.

Tretjet mund të fitohen me përzierjen e substancave nga të gjitha gjendjet agregate, po edhe vetë tretjet gjenden në të gjitha gjendje agregate.





Tretja përbëhet nga **tretësi** dhe **substancia e tretur**.



Tretës është substancia që është në sasi më të madhe dhe e cila është në gjendje të njëjtë agregate me tretjen e fituar.



Si tretës më i mirë është UJI.




Tretshmëria varet nga shumë faktorë:

1. Struktura e molekulës  
2. Shtypja
3. Temperatura




3V9340 [RM] © www.visualphotos.com



Sipas sasisë së substancës së tretur në sasi të caktuara të tretësit, tretja mund të jetë:

- 1. Tretje e pangopur** është tretje në të cilën, në kushte të dhëna, tretësi mund të tretë ende nga substanca e tretur.
- 2. Tretje e ngopur** është tretja e cila, në kushte të dhëna, në tretësin është tretur sasi maksimale e mundshme e substancës së tretur.
- 3. Tretje e tejngopur** tretja e këtillë përmban sasi më të madhe të substancës së tretur nga ai i ngopur. Nga tretjet e këtilla teprica e substancës së tretur precipiton (fundërron).

Saturated Solutions



Tretje e holluar - tretje të cilat përmbajnë sasi të vogël të substancës së tretur.

Tretje e koncentruar - tretja përmban sasi më të madhe të substancës së tretur.



CONCENTRATED

Notice how dark the solutions appears.

Lots of solute, in a small amount of solvent.

● Solute particle
● Solvent particle

Concentrated solution

DILUTE

Notice how light the solution appears.

Small amount of solute in a large amount of solvent.

Dilute solution



100 M



10 M



1 M



0.1 M



0.01 M